



UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Kryesues i Senatit
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 2701 Dt 02.11.2022

Senati i Universitetit "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 31.10.2022, nxjerr

VENDIM

Për plotësim - ndryshim të vendimit nr. 2195 dt. 30.09.2022 Për vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve për studentët e nivelit baçellor dhe master, të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve.

1. Titullit të vendimit nr. 2195 dt. 30.09.2022, në fillim të tekstit pas fjalës "Për" i shtohet teksti "vazhdim të studimeve" dhe pjesa tjetër e emërimit të vendimit mbetet e njëjtë. Pas ndryshimit, emërtimi i vendimit është: "Për vazhdim të studimeve dhe vazhdimin e kohëzgjatjes së afatit për përfundimin e studimeve për studentët e nivelit baçellor dhe master, të cilët e kanë kaluar periudhën e lejuar të kohëzgjatjes së rregullt të studimeve.

2. Pas pikës VIII të vendimit shtohen tri pika VIII a); VIII b) dhe VIII c) me këtë tekst:

VIII a). Studentëve të tjerë të nivelit të studimeve baçellor dhe master të cilët kanë pauzuar një apo dy vite dhe nuk kanë bërë kërkesë paraprake për pauzim, dhe aktualisht janë në vitin e parë, dytë, tretë apo katërt, u mundësohet vazhdimi i studimeve sipas plan-programit të ri ose aktual të studimeve pa pasur nevojë aplikimi përmes konkursit publik.

VIII b). Përjashtim nga pika VIII a) të këtij vendimi bëjnë studentët të cilët janë në programe të cilat nuk janë ri-akredituar.

VIII c). Studentët e vitit të fundit në programet të cilat nuk janë riakredituar, kanë të drejtë të vazhdojnë studimet sipas pikës VIII a) të këtij vendimi.

3. Pikat tjera të vendimit mbeten të pandryshuara.

Arsyetim

Bazuar në kërkesën e njëjësive akademike, për definimin e statusit të studentëve lidhur me të drejtën e vazhdimin të studimeve në rastin kur programet e studimit nuk janë riakredituar dhe lidhur me vitet e pauzionit – suspendimit të studimeve për studentët, Senati vendosi në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Dekanëve të njëjësive akademike;
3. Sekretarëve të fakulteteve;
4. Sekretarit të përgjithshëm;
5. Zyrës për shërbime të studentëve;
6. Zyrës së TI – së.



Prof. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit